

VENDIM
Nr.406, datë 21.6.2006

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.8, DATË 5.1.2002, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR TË
LUFTËS KUNDËR TRAFIKUT TË QENIEVE NJERËZORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.8, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 shtohet emërtimi “Zëvendësministri i Shëndetësisë, anëtar.”

2. Pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Me propozimin e zëvendësministrit të Brendshëm për çështjet e luftës kundër trafikut, Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj, analizon raportet për punën e kryer nga çdo institucion shtetëror dhe institucionet e tjera për zbatimin e detyrimeve, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, si dhe rekomandon zgjidhjet e mundshme për problemet e ndryshme.”.

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Njësia antitrafik drejtohet nga zëvendësministri i Brendshëm për çështjet e luftës kundër trafikut dhe, në bashkëpunim me personat përgjegjës për bashkërendimin e punës dhe të të dhënave, përfaqësues të institucioneve të përfshira në strategji, përgatit materialet referuese për mbledhje.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha